



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KQZ-së
Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Nr. Prot. 524 Dt 18.03.2021

THIRRJE

Për shprehjen e interesit për monitorim – vëzhgim të zgjedhjeve të studentëve në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" 2021.

- I. Në bazë të nenit 11, pika 4 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve, Universiteti "Isa Boletini", në Mitrovicë, u bënë thirrje të gjitha institucioneve, organizatave dhe palëve tjera për shprehje të interesit për monitorim të gjithë procesit të zgjedhjeve të studentëve të shpallura me vendimin e KD të UIBM dhe që do të mbahen më 12.04.2021.

Shprehja e interesit për monitorim të zgjedhjeve nga institucionet, organizatat dhe palët e tjera, bëhet në formë të shkruar dhe dorëzohet në zyrën ligjore të Universitetit të Mitrovicës. Aplikimi për monitorim duhet të përmbaj: Emrin e institucionit; dëshmi se është person juridik; emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar për monitorim; numri kontaktues dhe e – mail adresa.

- II. Në pajtim me nenin 16 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve: "Secila organizatë e studentëve që kualifikohet për pjesëmarrje në zgjedhjet e studentëve sipas kësaj rregulloreje, dhe e cila nuk është e përfaqësuar në komisionin zgjedhor apo në komisionet e fakultetit, ka të drejtë të nominojë një vëzhgues në komisionin zgjedhor". Në kuptim të nenit 16 ftohen organizatat studentore që të nominojnë vëzhgues në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Komisionet zgjedhore të fakulteteve.

Aplikimi për monitorim – vëzhgim të zgjedhjeve të studentëve bëhet më 29.03.2021, kurse certifikimi do të bëhet nga KQZ më 30.03.2021.

Universiteti "Isa Boletini, në Mitrovicë, është i përkushtuar për një proces të rregullt zgjedhor, transparent dhe korrekt.

Ju mirëpresim

